

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.  
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRICNOIA ENERGIJOM D.D.

KESCO - SH. A.

Nr. 631 Dt. 17 MAY 2023

PRISHTINË 1



Republika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Drejtësisë / Ministarstvo Pravde / Ministry of Justice Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar Agencija za Upravljanje Zapoljeno i Konfiskovane Imovine Agency for the Management of Sequestered or Confiscated Assets			
Nëse Org. Org. Jedin. Org Unit	<u>01</u>	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	<u>308</u>
Nr. i faqev Broj stranica No. pages:	<u>03</u>	Data Datum Date:	<u>15.05.23</u>
PRISHTINË/A			



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË MES AGJENCISË PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR / MINISTRIA E DREJTËSISË  
DHE

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE – KESCO

Bazuar në nenin 4 paragrafi 1 pika 1.13 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit në mes të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar/MD dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike- KESCO ( në tekstin e mëtejme Palët ) pajtohen të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi me qëllim zhvillimit dhe avancimit të bashkëpunimit.

Neni 1

Palët

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar/MD dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO SH.A.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është shkëmbimi i informacioneve dhe korigjimi i faturimeve paushallë për pasuritë e paluajtshme të cilat administrohen nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Neni 3

Obbligimet e-AAPSK

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar MD merr përsipër këto obligime:

Të bashkëpunoj dhe shkëmbej informata me shkrim me KESCO për pasuritë e paluajtshme të cilat janë nën administrim dhe për ato që do të pranohen në të ardhmen.

Të bashkëpunoj dhe shkëmbej informata me shkrim me KESCO për pasuritë e paluajtshme të cilat lirohen ose lëshon me qira.



Të njoftoj Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike - KESCO për çdo problem që mund të shfaqet gjatë kohës së administrimit të pasurisë.

Të marr përsipër të gjitha obligimet financiare nga data e pranimitt të pasurisë nga Agjencia duke përfshirë edhe të gjitha obligimet tjera që ndërlihen me pikat matëse nën administrim të Agjencës.

#### Neni 4

##### Obligimet e KESCO

Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO SH.A, merr përsipër këto obligime:

Të iniciojë procedurat përmbarimore për të gjithë pronarët/poseduesit e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, për obligimet që të njëjtit nuk i kanë përmbushur deri më datën kur këto pasuri janë marrë në administrim nga Agjencia.

Të bëjë Korigjimin e Faturimeve me vlerësim për pasuritë e paluajtshme të cilat janë nën administrim të Agjencisë duke filluar nga data e pranimitt të njoftimit nga Agjencia. (Të bëjë korigjimin e faturave për pasuritë e sekuestruar dhe të konfiskuara të cilat janë faturuar me vlerësim duke filluar nga data e pranimitt të pasurisë).

Të bëjë një shkëputje/ndërprerje nga shpenzimet e mëhershme dhe të filloj faturimin në bazë të konsumit të energjisë elektrike nga data e pranimitt të pasurisë në Agjenci deri në lirim të saj.

Të dërgoj faturat në adresën e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (adresa: Ndërtesa e Re e Qeverisë (Ish Ndërtesa e Rilindjes) Kati X, Zyra nr. 1017/A 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës).

#### Neni 5

##### Obligimet e përbashkëta

Me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje palët marrin përsipër që do të krijohet një grup i përbashkët i cili do të punoj në konstatimin e rasteve të faturimeve me vlerësim i cili do të vazhdoj edhe në të ardhmen për problemet e kësaj natyre ose të ngjashme.

#### Neni 6

##### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje bashkëpunimi pajtohen që me mirëkuptim, konsultim dhe negociim të zgjedhin të gjitha çështjet kontestuese që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje në të kundërtën, kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata kompetente në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

#### Neni 7



**Fillimi, ndryshimi dhe mbarimi i memorandumit**

Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit prej të dy (2) palëve dhe do të mbetet në fuqi deri sa të përfundojë apo të zëvendësohet me ndonjë instrument tjetër.

Ky Memorandum bashkëpunimi mund të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje mes palëve me pëlqim të ndërsjellë.

Nëse zbatimi i këtij Memorandumi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të fuqisë mbinatyrore – vis major dhe rrethanave të tjera të paparashikuara, palët do të vendosin bashkërisht për veprimet që duhet të ndërmerren.

Memorandumi mund të ndërpritet nga secila palë me marrëveshje mes tyre dhe me një njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve.

**Neni 8**

**Kopjet dhe gjuhët e memorandumit**


Memorandumi i bashkëpunimit është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale (nga një kopje në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe) për secilën palë nënshkruese dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët.

**Data e nënshkrimit:**

15/05/2023

**Enver Krasniqi**

Zv. Drejtor i Përgjithshëm, AAPSR



**Data e nënshkrimit:**

17/05/2023

**Mesut Serhat Dine**

Drejtor Menaxhues, KESCO

